



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 83 Akti

Nr. 177 Vendimi
Tiranë, më 8.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | | |
|---------------|---------------|-----------------|
| Etleda | Çiftja | Kryesues |
| Olsi | Komici | Anëtar |
| Roland | ILIA | Relator |

me sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdri, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datat 4.7.2019, ora 14:00 dhe 8.7.2019, ora 14:00, në Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERESIMIT : **Z. Alfred Agolli**, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

OBJEKTI : Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE : Nenet 179/b, A, Ç, D, DH, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të

subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Agolli, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Agolli ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe njëkohësisht është drejtues i saj. Në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.01.2018 nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Agolli, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioner Roland Ilia. Në datën 25.10.2018, komisionere Firdes Shuli paraqet kërkesën për dorëheqje nga ky trup gjykues për shkak të gjendjes në situatën e konfliktit të interesit. Me vendimin nr. ***, datë 25.10.2018, u ngrit trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Suela Zhegu dhe Brunilda Bekteshi me qëllim shqyrtimin e kësaj kërkesë, e cila u pranua me vendimin nr. ***, datë 29.10.2018. Komisionere Firdes Shuli u zëvendësua me komisionerin zëvendësues për çështjen në fjalë komisioner Olsi Komici.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Interesit (në vijim “ILDKPKI”) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, fillimisht ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, dhe më pas ka dërguar një raport të dytë me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2019.

5. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 17.04.2018.

6. Trupi gjykues, me hedhjen e shortit, administroi:

- raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga ILDKPKI-ja;
- raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016 nga DSIK-ja;
- raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016 nga IKLD-ja.

7. Trupi gjykues me vendimin nr. ***, datë 24.1.2018, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të

nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Alfred Agolli në lidhje me vlerësimin e pasurisë, me kontrollin e figurës dhe me rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues, komisionere Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

8. Trupi gjykues me vendimin nr. ***, datë 21.6.2019, vendosi:

- Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë, me kontrollin e figurës dhe me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Agolli.

- T'i njoftojë subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara për të tri kriteret, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, dhe atij i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të paragrafit 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

-Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 35 – 40 dhe 45 – 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

-Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin ditor brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

9. Trupi gjykues me vendimin nr. ***, datë 2.7.2019, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.7.2019, ora 14:00, në Pallatin të Koncerteve, salla B, kati 0 (underground), Tiranë.

10. Në datën 4.7.2019, ora 14:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli.

11. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli, bazuar në dy komponentë, atë të vlerësimit të pasurisë dhe të aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 2.7.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.7.2019, ora 14:00 në adresën: Pallati i Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim në Komision.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Alfred Agolli ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar por e njehta gje nuk mund te thuhet per kthimin e përgjigjeve pasi ka dhënë para Komisionit përgjigje kontradiktore. Ai ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni si dhe ka qenë korrekt gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për thirrjen e dëshmitarëve me qëllim që të provonte faktet dhe rrethanat e çështjes.

Në lidhje me kërkesën e subjektit për të thirrur dëshmitar me qëllim që të provonin faktet që kishte paraqitur subjekti i rivlerësimit, Komisioni vendosi mospranimin e saj, si kërkesë e pabazuar në ligjin nr. 84/2016, neni 49, pika 8 dhe më tej 6 e po të njëjtit nen, pasi për Komisionin fakti që u kërkua të provohej me dëshmitarë nga subjekti i rivlerësimit ishte provuar gjatë hetimit. Më tej, nëse i referohemi Kodit të Procedurës Civile, në rastin e një prove të plotë shkresore për të provuar faktin, marrja e një prove me dëshmitarë nuk lejohet, e thënë kjo sipas parashikimeve të nenit 232 të Kodit të Procedurës Civile, i cili specifikon: *“Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë.”*

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;

- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; dhe
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI subjekti i rivlerësimit deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

- ❖ **Apartament** banimi me sip. 68.5 m², ndodhur në Lagjja *** ose Lagjja ***, Rr. “****”, Gjirokastrë, blerë në shumën 3,000,000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.6.2007

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”

Çmimi i shitjes është likuiduar në datën 22.6.2016 ditën kur është lëvruar kredia.

Hetimi i kryer nga Komisioni¹

Arsyetim ligjor

1. Subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin me sip. 68.5 m², për çmimin 3,000,000 lekë, me kontratën e shitje nr. ***, në datën 20.6.2007.

Në kontratën e shitjes parashikohet se çmimi i shitjes do të likuidohet pasi të akordohet një kredi nga “Raiffeisen Bank”. Regjistrimi i kësaj kontrate referuar kartelës së pasurisë së këtij apartamenti është bërë në datën 20.6.2007, në po të njëjtën ditë është lëshuar certifikata për vërtetimin e pronësisë për këtë pasuri. Regjistrimi vërtetohet dhe me aplikimin “kërkesë për

¹ Shkresë nr. ***, datë 7.2.2018, drejtuar ZVRPP-ve.

Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.2.2018 dhe nr. *** prot., datë 12.2.2018, e ZVRPP- së Gjirokastrë.

Shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2018, drejtuar ZVRPP-së Gjirokastrë.

Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.10.2018, e ZVRPP-së Gjirokastrë.

Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2018, drejtuar të gjitha bankave të niveli të dytë.

Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2018, kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2018 kthim përgjigjeje “Tirana Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2018, kthim përgjigjeje “Intesa Sanpaolo Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2018, kthim përgjigjeje “BKT”.

Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2018, kthim përgjigjeje “Procredit Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 05.7.2018 drejtuar “Raiffeisen Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 10.7.2018, kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 11.7.2018, drejtuar “Raiffeisen Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2018, kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shkresë *** prot., datë 19.2.2018, DPT-ja ia delegon Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë trajtimin e kërkesës sonë.

Shkresë *** prot., datë 19.02.2018 kthim përgjigjeje DPT.

Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2018, kthim përgjigjeje DRT-ja Korçë.

Shkresë nr. *** prot., datë 4.4.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë.

Shkresë nr. *** prot., datë 16.4.2018, kthim përgjigjeje DRT-ja Korçë.

Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2018, drejtuar QKB-së.

Shkresë nr. *** prot., datë 27.2.2018, kthim përgjigjeje e QKB-së.

Shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2019, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.3.2019, e Prokurorisë së Rrethit Sarandë.

Shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2019, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.3.2019. e Prokurorisë Gjirokastrë.

regjistrim dhe lëshim certifikate/kopje” të bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit në datën 20.6.2007.

Pronësia mbi këtë apartament është konfirmuar nga ZVRPP-ja Gjirokastër nga ku rezulton se z. Alfred Agolli ka në pronësi pasurinë e llojit apartament me sip. 68.5 m², me nr. ***, z.k. ***, vol ***, f. ***.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se me kontratë kredie dhe hipoteke nr. ***, datë 22.6.2007, kjo pasuri është regjistruar në regjistrin e inskriptimeve në favor të “Raiffeisen Bank” ndërsa me deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.6.2016, është fshirë inskriptimi i datës 22.6.2007.

2. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga “Raiffeisen Bank” rezulton se me deklaratë noteriale nr. ***, subjekti i rivlerësimit i ka marrë hua shumën 3,000,000 lekë shtetasit N.Dh. Në këtë deklaratë përcaktohet se kjo shumë do të likuidohet pas marrjes së kredisë në “Raiffeisen Bank”.

- a. Nga subjekti i rivlerësimit kjo hua nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe në asnjë nga deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk rezulton të jetë likuiduar kjo shumë, pasi bazuar në deklaratimet e tij në deklaratën “Vetting” me kredisë e marrë ai ka kryer pagesën e shtëpisë blerë shtetasi V.B.
- Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit i është kërkuar informacion shtesë ku subjekti shpjegon: *“Në datën 21.6.2007 së bashku me shitësin V.B., ka shkuar në zyrën e drejtoreshës së “Raiffeisen Bank”, znj. R.Dh., e cila i ka thënë(me sa i kujtohet) se nuk mund të merrte shumën e kredisë prej 2.850.000(dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pasi duhej të kryhej më parë akti shitjes... por shitësi V.B., nuk ka pranuar të përfundonte akti shitjes, pra të kalonte pronësia tek ai, pa marrë lekët në dorë. Në këto kushte znj. R.Dh., i ka ardhur në ndihmë dhe i ka thënë se shuma prej 3.000.000(tre milionë) lekë do i tërhiqte nga llogaria e bashkëshortit të saj N.Dh., dhe do ja jepte shtetasit V.B., ndërsa shuma e kredisë 2.850.000(dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë do kalonte direkt në llogarinë e saj...Pra, në datën 21.6.2007, shitësi V.B., ka marrë 3.000.000 (tre milionë lekë) nga N.Dh., veprim i kryer në ambientet e zyrës së drejtoreshës së “Raiffeisen Bank”, znj. R.Dh., dhe po më këtë datë ka shkuar në hipotekë ku ka bërë regjistrimin e apartamentit që ka blerë, në emrin e tij i cili do ishte si garanci për kredisë që do merrte. Të nesërmen në datën 22.06.2007, në mëngjes, e ka njoftuar znj. R. Dh., se i ishte çelur kredia në shumën 2 850 000(dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) e cila ka kaluar direkt në llogarinë e shtetasit N.Dh., njëkohësisht këtij shtetasi i ka dhënë në dorë, po atë ditë, shumën prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë...*

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë hua nuk përputhen me të dhënat e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Çmimi i shitjes është likuiduar në datën 22.6.2016 ditën kur është lëvruar kredia”*.
- Regjistrimi i kontratës së shitjes referuar kartelës së pasurisë të këtij apartamenti është bërë në datën 20.6.2007 (dhe jo në datën 21.6.2007, siç pretendon subjekti i rivlerësimit), në po të njëjtën ditë është lëshuar certifikata për vërtetimin e pronësisë për këtë pasuri. Regjistrimi vërtetohet dhe me aplikimin “kërkesë për regjistrim dhe lëshim certifikate/kopje” të bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit në datën 20.6.2007. Ligjërish

subjekti i rivlerësimit është bërë pronar i apartamenti që në datën 20.6.2007 dhe nuk kishte asnjë pengesë ligjore për ta vendosur atë në hipotekë në favor të “Raiffeisen Bank”.

- Nga nxjerrja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se kredia është *disbursuar* në datën 25.6.2007 dhe jo në datën 22.6.2007, siç deklaroi subjekti i rivlerësimit. Shuma e *disbursuar* nuk ka kaluar në asnjë llogari të ndonjë personi të tretë siç pretendon subjekti i rivlerësimit por ajo është tërhequr *cash* nga subjekti në datën 25.6.2007.
- Nga Komisioni iu kërkua “Raiffeisen Bank” informacion në lidhje me gjendjen e llogarisë pranë kësaj banke të z. N.Dh., dhe znj. R.Dh.

Nga përgjigjet e “Raiffeisen Bank” rezulton se:

- Z. N.Dh., nuk ka kryer asnjë veprim bankar në datat 21 dhe 22 qershor 2007. Nga gjendja e llogarisë ai nuk e ka pasur gjendje shumë 3,000,000 lekë në datën 21.6.2007.
- Znj. R.Dh., në datë 21.6.2007 nga llogaria e pagës ka kryer tërheqje 500 lekë, 10,000 lekë, 10,000 lekë, ndërsa në datën 22.6.2007 nuk ka kryer asnjë veprim bankar. Nga gjendja e llogarisë ajo nuk e ka pasur gjendje shumë 3,000,000 lekë në datën 21.6.2007.

Për sa më sipër rezulton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me të dhënat e administruar nga Komisioni.

Subjekti, në lidhje me konstatimet e mësipërme në datën 21.10.2018, ka sqaruar se:

“Në lidhje me huan që i ka marrë shtetasit N.Dh., i është referuar deklaratës noteriale të datës 21.6.2007, të lidhur midis tij dhe shtetasit N.Dh.

Shitësi V.B., nuk ka pranuar të firmoste kontratën e shitjes, pra, të kalonte pronësia tek ai, pa marrë leket paraprakisht në dorë dhe nuk e ka firmosur kontratën dhe prandaj më datë 20.06.2007 i ka marrë hua shumë 3,000,000 lekë shtetasit N.Dh., dhe ia ka dhënë z. V.B.

Nuk e di dhe nuk i kujtohet nëse z. N.Dh., shumë që ia dha hua e tërhoqi nga banka apo e dispononte cash. Në shpjegimet që ka dhënë më parë në lidhje me këtë hua i është referuar vetëm deklaratës noteriale të datës 21.6.2007... Subjekti i rivlerësimit nuk e konsideron që shtëpinë e ka blerë me huan që i ka dhënë z. N.Dh.”

Nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit rezulton se:

- Ka ndryshuar deklarin e tij në lidhje me datën e marrjes së kësaj shume hua pasi tashmë deklaroi se e ka marrë në datën 20.6.2007 ndërkohë është e paqartë se pse deklarata noteriale është bërë në datën 21.6.2007, për sa kohë ai në datën 20.6.2007 ka nënshkruar kontratën e shitjes së apartamentit nuk ka arsye se pse të mos deklarohet në kontratën e shitjes se çmimi ishte paguar me huan e marrë z. N.Dh.
- Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me kohën e pagimit të çmimit dhe burimit për pagimin e çmimit të apartamentit nuk përputhet me deklarin e tij në deklaratën “Vetting” ku ai ka deklaruar se: *“Çmimi i shitjes është likuiduar në datën 22.6.2016 ditën kur është lëvruar kredia.”*
- Subjekti i rivlerësimit deklaroi se me shumë 3,000,000 lekë ka paguar shitësin e apartamentit pasi ai nuk pranoi të firmoste kontratën, ndërkohë në kontratën e shitjes në nenin me emërtim “mënyra e likuidimit” parashikohet se: *çmimi i shitjes do të likuidohet nga blerësi pasi të akordohet një kredi nga “Raiffesien Bank” Gjirokastër.*

Pra, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shitësi nuk pranoi të firmoste kontratën pa marrë shumë 3,000,000 lekë, nuk përputhet me përcaktimet e kontratës së nënshkruar prej tij.

- Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të provonte burimin e ligjshëm të ardhurave të z. N. Dh., për dhënien e huas në shumën 3,000,000 lekë, si dhe dokumentacion provues për shlyerjen e huas. Gjatë hetimit administrativ ai nuk dorëzoi asnjë dokumentacion provues në lidhje me sa iu kërkua.
- **Nga subjekti i rivlerësimit u kërkua që të pyeten në cilësinë e dëshmitarit z. N. Dh., znj. R.Dh., dhe z. V.B.**

Lidhur me thirrjen e z. V.B., si dëshmitarë argumentojmë se konstatimet në lidhje mbi mënyrën e likuidimit të çmimit të këtij apartamenti mbështeten në dokumentacion zyrtar të formalizuar përpara një noteri publik (kontrata e shitblerjes), i cili juridikisht ka vlerë të plotë, deri në provën e kundërt. Për këtë arsye bazuar në germa “a”, të nenin 49/6 të ligjit nr. 84/2016 është e panevojshme thirrja e tij si dëshmitarë.

- Lidhur me thirrjen si dëshmitarë të znj. R.Dh., dhe z. N.Dh., Komisioni thirri si dëshmitarë znj. R.Dh., të cilës në zbatim të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016 iu kërkua të provojë me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave për dhënien e shumën 3,000,000 lekë subjektit të rivlerësimit.

Komisioni i kërkoi dëshmitares të paraqiste dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të saj, por pavarësisht kërkesave të Komisionit ajo nuk depozitoi asnjë dokumentacion për të provuar të ardhurat e ligjshme të saj dhe bashkëshortit për dhënien e huas.

Në përfundim të hetimit administrativ Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për sa më poshtë:

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” marrjen e huas në shumën 3,000,000 lekë, si dhe nuk e ka deklaruar këtë hua si burim për blerjen e apartamentit.**

Subjekti, pas kalimit të barrës të provës, sqaroi se: *“Në lidhje me faktin se në deklaratën “Vetting” apo në deklaratimet vjetore nuk jam shprehur për marrjen e huas në vlerën 3,000,000 lekë, nga shtetasi N.Dh., ashtu sikurse e kam sqaruar edhe në komunikimet e vazhdueshme, ky fakt është harruar nga ana ime, pasi ka qenë një hua e marrë vetëm për pak ditë dhe është bërë vetëm për përmbushjen e kushtit të vendosur nga banka.*

Si mjet të likuidimit të vlerës së apartamentit gjithmonë kam deklaruar kredinë e marrë tek “Raiffeisen Bank” ...Për sa i përket faktit që unë nuk e kam deklaruar në deklaratën “Vetting” këtë hua duhet të sqaroj se është një hua për një përrudhë 4 – 5 ditore, në data 20-25 qershor 2007 deri 23-24 qershor 2007 ditë pushimi e shtunë e diel), para 12 vjetësh dhe kujtesa e harresa bëjnë të vetën.”

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit nuk shpjeguar bindshëm qëllimin e marrjes së huas në shumën 3,000,000 lekë.**

Pas kalimit të barrës të provës subjekti sqaroi se: *“Huaja është marrë për t’ia dhënë z. V. B., në mënyre që ai të më firmoste aktin e shitjes pasi i kërkonte lekët cash në dorë në datën 20.6.2007.*

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit nuk e vërteton me dokumentacion provues kthimin e huas në shumën 3,000,000 lekë shtetasit N.Dh.**

Pas kalimit të barrës të provës subjekti ka paraqitur *deklaratën noteriale të z. N.Dh., me nr. ****, ku konfirmohet shlyerja e huas.

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion provues përdorimin e huas në shumën 3,000,000 lekë për pagimin e apartamentit.**

Pas kalimit të barrës të provës subjekti sqaroi se: *“Në datën 20.6.2007 unë i kam dorëzuar cash z. V.B., shumën 3,000,000 lekë, të cilat i mora hua nga z. N.Dh ...Faktin që unë nuk i kisha lekët dhe këtë shtëpi do t’ia merrja me kredi e sqaron edhe deklarata noteriale bërë nga z. V.B., në datën 8.6.2007, deklaratë kjo e bërë pas bisedës paraprake me mua, si për çmimin edhe për mënyrën e likuidimit të vlerës së apartamentit.”*

- ✓ **Subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. N.Dh., për dhënien e huas në shumën 3,000,000 lekë.**

Pas kalimit të barrës të provës subjekti sqaroi: *“Për sa i përket burimeve financiare të z. N. Dh., në momentin që ai më ndihmoi në datën 20.6.2007 duke më dhënë 3,000,000 lekë cash... e konsideroj si sjellje timen “non – sens” (e pa vend, jo etike, jo njerëzore) që unë atë moment ti kërkoja burimin e të ardhurave apo faktin se ku i kishte (ku i mbante) lekët. Ndërkohë që unë e dija që ai dhe bashkëshortja e tij ishin një familje e nderuar pa asnjë konflikt me ligjin dhe që z. N.Dh., kishte një aktivitet tregtar prej vitesh dhe znj. R.Dh., ishte drejtoreshë rajonale në “Raiffeisen Bank” ...Megjithatë me kërkesën time znj. R.Dh., u tregua e gatshme dhe më vuri në dispozicion dokumentacionin për të ardhurat e saj nga paga.*

Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Tatimeve Gjirokastër si dhe nga të dhënat e marra nga dosja e hetimit administrative duket qartë se z. N.Dh., ka të ardhura të mjaftueshme kundrejt huas 3,000,000 lekë.”

Komisioni, pasi analizoi provat e depozituar nga subjektit, si dhe shpjegimet e tij, konkludon se ai nuk ka arritur të provojë me dokumentacion provues ligjor burimin e ligjshëm të ardhurave të z. N.Dh. Dokumentacioni i dorëzuar prej tij në lidhje me të ardhurat e z. N.Dh., nuk ka të pasqyruar fitimin e realizuar nga ana e tij në mënyrë që të bëhet një llogaritje e saktë për sa i përket aftësisë paguese të z. N.Dh. Në lidhje me rezultatet e tjera të barrës së provës shpjegimet e subjektit janë në nivel deklarativ dhe ai nuk ka depozituar asnjë provë për të provuar se huaja është marrë në datën 20.6.2007 dhe se ajo i është dhënë z. V.B. Ndërkohë nga aktet e administruar nga Komisioni, më konkretisht kontratës së blerjes së këtij apartamenti, rezulton se pagesa do të bëhej pas marrjes së kredisë dhe se bazuar në shkresën e ZVRPP-së Gjirokastër apartamenti është regjistruar që në datën 20.6.2007 pa pasur nevojë për likuidimin e çmimit të blerjes sikundër parashikohet në kontratë. Nëse marrim për bazë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit huaja përbën burimin e ligjshëm për shlyerjen e apartamentit, dhe si e tillë duhej të deklarohet në deklaratën “Vetting”.

- ❖ **Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” si burim të ardhurash për blerjen e këtij apartamenti ka deklaruar kredinë me kontratë, nr. *****, datë 22.6.2007, në shumën 2,850,000 lekë, marrë në “Raiffeisen Bank” me qëllim blerje shtëpie. Afati 300 muaj.

a. Nga nxjerrja e llogarisë së kësaj banke rezultojn se:

- në datën 25.6.2007 është *disbursuar* kredia në shumën 2,850,000 lekë;

- në datën 22.6.2007 nga subjekti i rivlerësimit është depozituar shuma 175,000 lekë;
 - në datë 25.6.2007 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 3,000,000 lekë pranë kësaj banke ku përfshihet dhe kredia;
 - në datë 02.7.2012 subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën 2,772,692 lekë ku përfshihet dhe borxhi i marrë shtetasit L.M.;
 - në datën 04.7.2012 subjekti i rivlerësimit ka shlyer kredinë në shumën 2,687,079.19 lekë.
- b. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se për të shlyer kredinë në “Raiffeisen Bank” me kontratë huaje nr. ***, në datën 9. 6.2012, i ka marrë hua shtetasit L.M., (kunati i subjektit) shumën 1,000,000 lekë me afat kthimi 3 vjet pa interes.

Kjo shumë është tërhequr nga shtetasi L.M., në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 1.6.2012 bazuar në njoftimin nr. *** të “Intesa Sanpaolo Bank”. Në lidhje me aftësinë financiare të z. L.M., për dhënien e huas në shumën 1,000,000 lekë i është kërkuar subjektit të rivlerësimit të depozitohet dokumentacioni provues mbi burimin e ligjshëm të ardhurave të z. L.M. Subjekti, në datën 21.10.2018, sqaron: *“Z. L.M., nga viti 1993 është bërë kunati i tij dhe deri aktualisht ka pasur aktivitet tregtar. Tërheqja e shumës 1.000.000 (një milionë) lekë që ka marrë hua nga L.M., është bërë në datën 1.6.2012 në “Intesa Sanpaolo Bank”, dega Korçë. Kjo depozitë është krijuar në datën 6.3.2006.”*

Për të provuar deklarin e tij subjekti i rivlerësimit vë në dispozicion të Komisionit:

- kontratë depozitë bankare, datë 6.3.2006, në shumën 980,000 lekë, hapur në “Bankën Amerikane të Shqipërisë” në emër të z. L.M.;
- ekstrakt historik të shoqërisë “****” sh.p.k.;
- ekstrakt historik të personit fizik A.M.;
- certifikatë regjistrimi në emër të znj. A.M.;
- certifikatë regjistrimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore;
- nxjerrje llogarije bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të z. L.M., dhe znj. A.M.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokument (vërtetim për pagat, dividend nga shoqëritë etj.) për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. L.M., që kanë shërbyer për krijimin e depozitës dhe dhënie e huas, pavarësisht faktit se z. L.M., ka pasur llogari bankare që në vitin 2006.

Për sa më sipër subjektit i kaloi barra e provës për të provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave të z. L.M., për dhënien e huas në shumën 1,000,000 lekë.

Pas kalimit të barrës të provës subjekti i rivlerësimit sqaroi: *“Për sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave të z. L.M.: siç kam sqaruar dhe më përpara kunati im, z. L.M., ka pasur aktivitet tregtar nga viti 1993 (para se të bëhej kunati im), për këtë arsye ai kishte mundësi financiare të më jepte hua në shumën 1.000.000 lekë... Unë po ju paraqes dokumentet tatimore personale të z. L.M., nga të cilat provohet se të ardhurat e tij mbulojnë plotësisht vlerën e huas prej 1.000.000 lekësh (shih dokumentet bashkangjitur)”*.

Subjekti i rivlerësimit së bashku me shpjegimet ka vënë në dispozicion pagesat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2003 – 2006 të z. L.M. Nga analizimi i dokumentacionit rezultoi se z. L.M., ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas subjektit të rivlerësimit z. Alfred Agolli.

Në përfundim rezulton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e apartamenti.
 - ii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave të z. N.Dh., për dhënien e huas në shumën 3,000,000 lekë.
 - iii. Subjekti i rivlerësimit i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me huan e marrë nga z. N.Dh.
- ❖ **Automjet tip “BMW”** blerë me kontratë shitje nr. ***, në datën 6.12.2008, për shumën 300,000 lekë.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Nuk ka deklaruar burim.

Hetimi i kryer nga Komisioni²

Analiza e provave

1. Automjeti tip “BMW”, me targa AA ***, është blerë me kontratë nr. ***, në datën 6.12.2008, për shumën 300,000 lekë.

Në përfundim rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

2. Subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard deklaroi se përdor shpesh mjedin e vjehrrës së tij, z. K.M.

DPSHTRR-ja me shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2018, na informon se znj. K.M., nuk është e pajisur me leje drejtimi ky fakt konfirmohet dhe nga subjekti.

Në lidhje me këtë mjet iu kërkua informacion më i detajuar subjektit të rivlerësimit. Në përgjigjen e tij subjekti shpjegon se mjeti është blerë nga vjehrra e tij dhe përdoret më shumë nga vjehrra. Ky mjet është vënë në emër të vjehrrës pasi vjehrra i tij ka një mjet tjetër në pronësi. Subjekti deklaroi se mjeti përdoret shpesh nga ana e tij por nuk është në posedim të tij.

Nga të dhënat e AMF-së rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka prerë policë sigurimit për këtë mjet në datën 23.9.2014, për periudhën 23.09.2014 – 22.09.2015

Për sa më sipër subjekti i rivlerësimit nuk është i saktë në shpjegimin e tij pasi mjedin në pronësi të vjehrrës së tij nuk e ka në përdorim të thjeshtë për sa kohë bashkëshortja e tij ka prerë policinë e sigurimit. Në lidhje me këtë konstatim është pyetur subjekti i rivlerësimit i cili sqaron: *“Është e vërtetë se bashkëshortja e tij nuk e ka drejtuar kurrë mjedin, pavarësisht se ka leje drejtimi për mjet. Për rastin që ne kërkojmë, është paraqitur bashkëshortja e tij së bashku me lejen e qarkullimit të mjetit dhe ka paguar siguracionin. Ka pasur dëshirë që për atë vit ta paguante ajo siguracionin dhe është vendosur emri saj.”*

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me të dhënat e administruara nga AMF-ja pasi si përdorues i këtij mjeti në policën e sigurimit rezulton bashkëshortja e tij e cila e ka

² Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2018, drejtuar DPSHTRR-së.

Shkresë nr. ***prot., datë 20.2.2018, kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja.

Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2018, kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja.

deklaruar me vullnetin e saj. Në lidhje me këtë konstatim subjektit iu kërkuan shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit.

Pas dërgimit të rezultateve ai sqaroi: *“Sqaroj se ky mjet nuk ka dalë asnjë herë jashtë qytetit të Gjirokastrës. Unë e kam përdorur në Gjirokastrë rrallë herë për ndonjë nevojë të ngutshme. Ndërkohë që i qëndroj deklaramit se bashkëshortja ime megjithëse ka patentë nuk e ka përdorur asnjëherë këtë mjet (ka fobi). Ditën që është paguar policën e sigurimit ajo ka qenë në mjet (jo drejtuese mjetit). Prerësi i siguracionit i kërkoi një kartë identiteti pa përmendur nëse është përdorues ose jo (asaj ju ndodh me vete) dhe ajo e preu policën në emër të saj”.*

Komision, bazuar në dokumentacionin e administruar por dhe në përgjigjet e subjektit, vlerëson se ai ka qenë bindës në shpjegimet e tij, si dhe nuk u arrit të provohej se makina ishte në përdorim të vazhdueshëm apo në posedim të subjektit, për rrjedhojë ai nuk kishte detyrimin ligjor për ta deklaruar në deklaratën “Vetting”.

❖ **Depozitë në shumën 1,100,000 lekë**, në datën 18.5.2016, në “Raiffeisen Bank”.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: Nuk ka deklaruar burim.

Hetimi i kryer nga Komisioni³

Analiza e provave

Subjekti i rivlerësimit në datën 18.5.2016 ka lidhur kontratën e depozitës me afat në “Raiffeisen Bank” për shumën 1,100,000 lekë. Ky fakt konfirmohet dhe nga shkresa e “Raiffeisen Bank”.

Në përfundim rezulton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Ndërkohë, me shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2019, DSIK-ja ka dërguar një raport të dytë për subjektin e rivlerësimit nga ku rezulton se:

Nga informacioni i ardhur prej institucionit të verifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli, rezulton se:

“...me profesion avokat është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e përpjekjeve për ushtrimin ndikimi të paligjshëm ndaj shtetasit Alfred Agolli për favorizimin e pozitës së të pandehurit...”

³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

Shkresë nr. ***prot., datë 12.2.2018, kthim përgjigjeje “Raiffeisen Bank”.

Dyshohet se avokati ka ndërhyrë tek prokurori i çështjes, z. Alfred Agolli, për të mundësuar ndryshimin e masës së sigurisë, nga “arrest në burg” në “detyrim paraqitje”.

Për sa sipër, në vlerësimin e të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjekti e rivlerësimit, gjykojmë se:

1. *Bazuar në informacionet e ardhura merret në konsideratë aktualiteti i të dhënës dhe fakti se mbi veprimtarinë e paligjshme të këtij prokurori, janë informuar..., si instancat përgjegjëse për trajtimin dhe shqyrtimin e rasteve të tilla.*
2. *Informacioni që disponohet në ngarkim të prokurorit Alfred Agolli për implikim në veprimtari të kundërligjshme nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, e bën subjektin e rivlerësimit, në mbështetje të germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016 person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.*
3. *Sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 që përfshin veprën penale sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit.*
4. *Bazuar në nenin 38, të ligjit nr.84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krim e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjektit me krimin e organizuar, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit është subjekt i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.”*

Në përfundim Grupi i Punës ka rishikuar konstatimin fillestar për subjektin e rivlerësimit duke arritur në përfundim mbi *papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit*

Në lidhje me përfundimin e DSIK-së subjektit iu dha e drejta për të dhënë komente ose jo me dërgimin e rezultateve të hetimit.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve, sqaron: *“Në lidhje me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, nuk jam aspak dakord. Në vendimmarrjen time si prokuror apo drejtues, nuk ka pasur ushtrim të ndikimi të paligjshëm nga askush dhe në asnjë rast. Vendimet dhe kërkesat e mia drejtuar Gjykatës janë marrë në respektim të ligjit procedural penal dhe material si dhe bindjes time të brendshme. Nuk jam ndikuar asnjëherë në kërkesa apo vendime të marra prej meje, nga avokatë apo faktorë të tjerë. Besoj në një vlerësim të drejtë nga ana Juaj, për vlerësimin e figurës time”.*

Raporti i Grupit të Punës së DSIK-së (informacioni që përmbante) iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e rrethanave që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanave lehtësuese, të rrjedhura nga informacioni që kishte marrë Grupi i Punës dhe kishin çuar në konstatimin e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës, si dhe vërtetësisë së ngjarjes konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor. Hetimi i pastërtisë së figurës u shtri më tej nga Komisioni i cili zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht. Nga relatori u krye verifikimi i informacionit që kishte mbledhur DSIK-ja për përgatitjen e këtij raporti.

Standardet e kontrollit të figurës i përcakton vetë ligji. Gjithë procesi duhet të zhvillohet bazuar në prova të sakta në mënyrë objektive. Referuar nenit 38, “standardet e kontrollit të figurës”, pika 3, parashikon se: *“Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve*

që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.”

Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi për sa i përket kontrollit të figurës përcaktohet në paragrafin 4, të nenit 38, të grupuara në 5 kategori:

- a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.

Në këtë rast, informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38, i ligjit nr. 84/2016, prandaj ai konsiderohet i paplotë. Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet ta kryejë atë gjithnjë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij. Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 17.4.2018.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;

- 2) pesë dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
 - 3) të dhënat nga burimet arkivore të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.
 - Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
 - Denoncimet e paraqitura në Komision.
 - Hetimin e kryer nga Komisioni, si më poshtë
- Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2019, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 23.1.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2019, drejtuar Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
Kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 23.01.2019, e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 22.01.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
Kthim përgjigjeje, nr. ***, datë 24.1.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm rezultojnë:

1. Në lidhje me dokumenti ligjor, “konkluzione”, datë 20.7.2015, “Mbi shqyrtimin e vendimit penal nr. *, datë 12.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndaj të pandehurit A.Q., akuzuar për veprën penale ”vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim”, “vjedhje” dhe “prodhimi dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278, paragrafi 2, të Kodit Penal dhe nenin 134/1 i Kodit Penal; si dhe ndaj të pandehurit D.K., akuzuar për veprën penale ”vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 141 e 25 të Kodit Penal.**

Me këtë akt, subjekti i rivlerësimit bazuar në germa “a”, pika 1, të nenin 428, të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar: “Ndryshimin e pjesshëm të vendimit penal nr. ***, datë 12.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndaj të pandehurve A.Q., dhe D.K., për sa i përket masës së dënimit të dhenë ndaj tyre, dhe kërkuar burgim të përjetshëm.”

Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. ***, datë 4. 6. 2015, ka vendosur: “Lëniën në fuqi të vendimit nr. ***, datë 12.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në lidhje me fajësinë, cilësimin ligjor të veprave penale të kryera nga të pandehurit, mënyrën e vuajtjes së dënimit me burgim...; Ndryshimin e vendimit në lidhje me masën e dënimit të caktuar ndaj të pandehurve A.Q., dhe D.K., dhe dënimin e tyre me burgim të përjetshëm.”

Në pjesën hyrëse të këtij akti për të pandehurin A.Q., nuk janë cituar dispozitat e Kodit Penal, neni 141 dhe 25, që parashikojnë veprën penale të ”vjedhjes me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim”. Në lidhje me bazën ligjore subjekti i rivlerësimit ka cituar vetëm nenin germën “a”, të 428/1 të Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë që duhej të citohej dhe germa “b”, e nenin 428/1, të Kodit të Procedurës Penale .

Trupi gjykues vlerëson se mos citimi i dispozitave të Kodit Penal apo të Kodit të Procedurës Penale nuk përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

2. Në lidhje me konkluzionet e prokurorit (dosja 2), datë 6.7.2016, mbi ankimin ndaj vendimit penal nr. *** (***), datë 19.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ndaj të pandehurit B.R.

Me këtë akt, subjekti i rivlerësimit mbështetur në nenin 428/1 gërma “a”, “b” të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar: *“Ndryshimin e pjesshëm të vendimit penal nr. *** (***), datë 19.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në lidhje me mënyrën e vuajtjes së dënimit, duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për një afat 2 vjet, në bazë të nenit 59, të Kodit Penal.”*

Nga subjekti i rivlerësimit nuk trajtohen në mënyrë të detajuar kriteret e parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal për të argumentuar kërkesën e tij për ndryshimin e mënyrës së vuajtjes së dënimit.

Trupi gjykues vlerëson se mosdetajimi i kriterëve të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

3. Në lidhje me konkluzione(dosja 3), datë 4.12.2013, “Mbi ankimin e vendimit penal nr. ***, datë 16.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër (masë sigurimi)”.

Me këtë akt subjekti i rivlerësimit në mbështetje të germës “a” të pikës 1, të nenit 428, të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar: *“Miratimin e vendimit penal nr. ***, datë 16.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ndaj personit nën hetim E.H.”*

Me vendimin nr. ***, datë 4.12.2013, Gjykata e Apelit Gjirokastër ka vendosur: *“Miratimin e vendimit nr. ***, datë 16.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër”*.

Norma ligjore e identifikuar nga prokurori për të mbështetur kërkimet e tij është e gabuar pasi ai duhej ti referohej nenin 249/6 të Kodit të Procedurës Penale.

Trupi gjykues vlerëson se identifikimi i gabuar i normës ligjore nuk përbën shkak për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

4. Në lidhje me konkluzione(dosja 4), datë 10.10.2013, “Mbi ankimin e vendimit penal nr. ***, datë 04.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, ndaj të gjykuarve A. B., dhe B.B.”.

Me këtë akt subjekti i rivlerësimit në mbështetje të germës “b”, të nenit 428/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar nga gjykata:

*“Ndryshimin e pjesshëm të vendimit penal nr. ***, datë 4.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, si më poshtë:*

1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit A.B., për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.*

2. *Deklarimin e fajtor të të pandehurit A.B., për veprën penale “goditja për shkak të detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 237 dhe 25, të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.*

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit A.B., për veprën penale “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 278/2 e 25, të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

4. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal kërkoj përfundimisht dënimin e të pandehurit A.B., me 2 vjet e 5 muaj burgim.

5. Deklarimin fajtor të të pandehurit B.B., për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

6. Deklarimin e fajtor të të pandehurit B.B., për veprën penale “goditja për shkak të detyrës”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 237 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

7. Deklarimin e fajshëm të të pandehurit B.B., për veprën penale “prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 278/2 e 25, të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

8. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal kërkoj përfundimisht dënimin e të pandehurit B.B., me 2 vjet e 5 muaj burgim.

9. Lënien në fuqi të vendimit të gjykatës për sa i përket pushimit të çështjes në lidhje me fajësinë e të pandehurve për akuzën e “plagosjes së lehtë me dashje”, neni 89 i Kodit Penal.”

Nga subjekti i rivlerësimit është bërë referim vetëm në germën “b”, të nenit 428/1, të Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë që duhej të bëhej referim dhe në germën “a”, për sa kohë ka kërkuar lënien në fuqi të një pjese të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Trupi gjykues vlerëson se referimi vetëm në germën “b” nuk përbën shkak për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

❖ **Në lidhje me të dhëna nga burime arkivore**

Nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Sektorit të Arkivit, etj, në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe informacionet/përgjigjet e ardhura nga gjithë prokuroritë e rretheve gjyqësore nuk rezultojnë të dhëna për masa disiplinore të dhëna subjektit të rivlerësimit apo kallëzimi/procedim penal të regjistruar ndaj tij.

❖ **Në lidhje me Raportin e Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë “Mbi rezultate e kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Inspektimit të kësaj ministrie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”, për periudhën 1.1.2013 – 31.5.2014.**

Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme gjendet i administruar Raporti i Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë “Mbi rezultate e kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Inspektimit të kësaj ministrie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë“ për ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorëve të kësaj prokurorie gjatë trajtimit të procedimeve penale që kanë përfunduar me vendim mosfillim të procedimit penal dhe vendim pushimi, për periudhën 1.1.2013 – 31.5.2014. Komisioni, pasi ka analizuar këtë raport, si dhe raportin e hartuar nga ana e Prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme, konstaton se:

Subjekti i rivlerësimit nuk i ka njoftuar vendimin e mosfillimit palëve të interesuara që kanë bërë kallëzim ose ankim si detyrim ligjor i parashikuar nga neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor cenon të drejtën procedural të palëve për t’u njohur me vendimin e prokurorit me qëllim ushtrimin e të drejtës së ankimit në gjykatë, ose pranë

prokurorit më të lartë. Mos respektimi i këtij detyrimi ligjor është evidentuar në dy raste si më poshtë:

- Kallëzim penal nr. ***, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit të Procedurës Penale.
- Kallëzim nr. ***, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i Kodit të Procedurës Penale.

Trupi gjykues vlerëson se mosnjohimi i palëve në proces nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

1. Në trajtimin e materialit kallëzues **nr. ***, datë 26.3.2013** që bënë fjalë për veprën penale “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, dhe shpërdorim detyre”, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 248 të Kodit Penal.

Kallëzimi penal është bërë nga shtetasi N. P., drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ja ka përcjellë për kompetencë Prokurorisë Sarandë. Në kallëzim shtetasi N. P., deklaron se gjyqtari P.A., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka qenë në vijimësi i njëanshëm në gjykimin e një çështjeje civile në vitin 2010, me palë paditëse shoqëria T., i paditur shoqëria P.... Ai ka kallëzuar se gjyqtari në mënyrë të drejtpërdrejtë ka bërë kërkesë për marrje *mite* në shumën 5,000 euro në këmbim të dhënies së vendimit në favorin e tij edhe pse shoqëria P. kishte të drejtë. Për këtë ai deklaron se ka bërë kallëzim penal në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Shtetasi N. P., kallëzon se në vijim të gjykimin të çështjes civile të mësipërme shtetasi A. T., (djali i palës paditëse) është takuar me gjyqtarin në ambientet e gjykatës në datën 7.1.2013 jashtë orarit zyrtar nga ora 19:00 -20:00, takim i cili është i filmuar nga kamerat e sigurisë së gjykatës.

Me vendimin, datë 3.5.2013, subjekti i rivlerësimit, bazuar në germën “dh”, të nenit 290/1, të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin e procedimit penal duke arsyetuar midis të tjerave se : “..çështja objekt kallëzimi është hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyrokastër, mbështetur në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale dhe është vendosur pushimi i çështjes me arsyetimin se nuk provohet kryerja e veprës penale. Për sa më sipër duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin nr. ***, mbështetur në germën “dh”, të nenit 290/1, të Kodit të Procedurës Penale”.

Pas analizës së raportit të inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit i është kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme të paraqiste dosjen e materialit kallëzues **nr. ***, datë 26.3.2013**. Nga verifikimi i dosjes rezulton se:

a. Vendimi i Prokurorisë së Shkallës së Parë Gjyrokastër për të pushimin e çështjes penale nr. ***

Në datën 2.5.2011, shtetasi N.P., ka bërë kallëzim penal, i cili fillimisht u bë pranë Njësisë së Krimit Ekonomik të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga kjo e fundit u dërgua në Prokurorinë e Rrethit Gjyrokastër.

Shtetasi N.P., administrator i shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., që kryente punime ndërtimi në Sarandë, ishte paditur më parë më 14.12.2010 nga shtetasi Sh.T. Gjykimi civil midis të dyve është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Sarandës nga gjyqtari P.A.

Sipas deklaratave të shtetasit N. P., para prokurorisë në dhjetor të vitit 2010 gjyqtari i kësaj çështje civile, z. P.A., duke njohur një mik të N. P., (shtetasin F. P.), i kërkoi këtij të fundit (F. P.) të shërbejë si ndërmjetës dhe të kërkojë shumën 5,000 euro nga “****” sh.p.k, në mënyrë që të mund të jepte një vendim në favor të tyre. Pretendohet, se gjyqtari ka thënë gjithashtu se edhe pse “****” sh.p.k. ka të drejtë dokumentet janë në favor të tyre, pala tjetër ka ofruar një shumë më të lartë si *ryshfet* për zgjidhjen e çështjes në favor të tyre. Shtetasi F. P. informoi se shtetasi N. P. brenda së njëjtës ditë. N. P. nuk e besoi këtë, kështu që, ai kërkoi një takim me gjyqtarin. Në mbrëmje, së bashku me F. P., N. P., u takua me gjyqtarin P.A., dhe ai kërkoi shumën 5,000 euro të cilat duhet të jepen përmes F. P. të nesërmen, N. P. pretendon se ka tërhequr shumën 5,000 euro nga “NBG”-ja Sarandë dhe i kishte dhënë shumën F.P., që pretendonte se ia kishte dhënë atë gjyqtarit. Në datën 22.12.2010 gjyqtari ka nxjerrë një vendim për të pranuar pjesërisht padinë e SH. T., duke urdhëruar pezullimin e punimeve të ndërtimit të shoqërisë “****” sh.p.k., në një pjesë të zonës së ndërtimit. Gjyqtari gjithashtu caktoi 3 ekspertë për të verifikuar distancat e objektit në ndërtim dhe pajtueshmërinë me legjislacionin e planifikimit urban. Shtetasi N. P. pretendon se një nga ekspertët ishte kërcënuar nga paditësi për mosnxjerrjen e një akti ekspertize në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. Përmendet shkëmbimi i sms-ve mes gjyqtarit dhe shtetasit N.P. Në mars të vitit 2011, një anëtar tjetër i shoqërisë “****” sh.p.k., shtetasi S.A., u takua dy herë me gjyqtarin i cili pretendonte se pala tjetër në gjykim kishte ofruar më shumë para dhe për të vendosur përfundimisht në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., ai kërkonte një apartament në objektin që po ndërtohej. Shtetasi N.P., ka komunikuar përsëri me shtetasin F.P., dhe ky i fundit ka vazhduar komunikimet me gjyqtarin duke pretenduar se çështjet ishin afër zgjidhjes.

Në datën 2.5.2011, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor të Sarandës ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2011. Pas regjistrimit të procedimit penal u kryen disa veprime hetimore, si dhe përgjimi i shtetasve N.P. dhe F.P.

Në datën 9.8.2011, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor të Sarandës vendosi të mbyllë çështjen me argumentin se veprat penale nuk provohen.

b. Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Sarandës (ku subjekti i rivlerësimit, ka qenë prokuror i çështjes) për mosfillimin e procedimit penal mbi kallëzimin penal nr. * të vitit 2013.**

Në datën 14.01.2013, shoqëria “****” sh.p.k., ka depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme një denoncim ndaj gjyqtarit P.A., me pretendimin për korrupsion në gjykimin e çështjes civile nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Denoncimi /ankesa për marrjen e një *ryshfeti* në shumën prej 5,000 eurosh e përmendur tashmë në kallëzimin e parë penal (më sipër) përsëritet sërish. Për më tepër, tashmë, shtetasi N.P., pretendon se djali i paditësit në gjykimin civil të lartpërmendur (shtetasi A.T) ka takuar gjyqtarin P.A., në ambientet e gjykatës në datën 7 janar 2013 (kjo datë është padyshim pas datës së vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Sarandës për mbylljen e çështjes në datën 9.8.2011). Pretendohet se nga gjyqtari është dhënë një vendim në mungesë të palës së paditur shoqërisë “****” sh.p.k, edhe pse çuditërisht në vendim gjyqtari

deklaroi se shoqëria “****” sh.p.k ishte e pranishme. Shtetasi N.P., pretendon se takimi i lartpërmendur është i regjistruar nga kamerat e sigurisë të gjykatës. Pretendohet se shtetasi A. T., i ka dhënë gjyqtarit vendimin e përgatitur gati me një *usb*. Mbi këto pretendime, shtetasi N. P. ka kërkuar nga prokuroria që të fillojë hetimet për gjyqtarin P.A. Në datën 25.3.2013, shtetasi P. P. e dërgoi ankesën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë si organi kompetent për ndjekjen e rastit/ çështjes. Në datën 15.4.2013 Prokuroria e Rrethit Sarandë (subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Agolli) kërkoi nga Prokurorisë së Gjirokastrës informacione mbi procedimin penal të administruar dhe hetuar nga shtetasi N.P. Në datën 30.4.2013 Prokuroria e Rrethit Gjirokastrës dërgoi një letër në Prokurorinë e Rrethit Sarandës duke shpjeguar shkurtimisht se bazuar në një kallëzim të vitit 2011 nga shtetasi N. P. ata kishin regjistruar një procedim penal dhe me vendim të datës 9.8.2011 çështja penale ishte mbyllur. Me vendimin e datës 3.05.2013, subjekti vendosi mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2013. Pa asnjë hap hetimor (me përjashtim të një letre nga Prokuroria e Rrethit Gjirokastrës) dhe me vendim të paarsyetuar, subjekti vendosi të mosfillojë procedimin penal me argumentin se rasti ishte hetuar tashmë nga Prokuroria e Rrethit Gjirokastrës e cila në fakt e pushoi çështjen. Baza ligjore e vendimit të tij për të mosfilluar procedimin penal është neni 290, paragrafi 1, shkronja “dh”, e Kodit të Procedurës Penale cila është në rastet e amnistisë. Nuk u bë asnjë akt i njoftimit të vendimit për shtetasin N.P.

Bazuar në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale çështja nuk mund të shqyrtohej nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për sa kohë z. P.A., ishte gjyqtar pranë kësaj gjykate.

→ Konkluzione

Pas vlerësimit të të dy dosjeve rezultoi se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të filluar procedimin penal, nuk ka kryer hetime paraprake, si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme hetimore, duke marrë në konsideratë faktin se në kallëzim paraqiteshin rrethana të ndodhura gjatë vitit 2013 pra, pas përfundimit të hetimeve për kallëzimin e vitit 2010;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar vendimin e mosfillimit;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar drejt dispozitat e Kodit të Procedurës Penale;
- subjekti i rivlerësimit nuk duhej të mbështeste mosfillimin e procedimit në pikën “dh” të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale;
- nuk rezulton palëve t’i jetë bërë njoftimi i vendimit të mosfillimit, në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 291/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këto konstatime, pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se:

“Për pjesën shtesë të kallëzimit të ri mendoj se nuk ka pasur elementë të figurës së veprës penale. Mendoj se kallëzimi është analizuar në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, dhe më pas është vendosur që të dërgohet në Prokurorinë Sarandë. Vendimi i mosfillimit është marrë pas konsultimit verbal me prokurorët e Sektorit Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme (pavarësisht së këtë nuk mund ta vërtetoj dot), por jam i sigurt që ka ndodhur, pasi prej tyre jam njoftuar që Prokuroria Gjirokastër e kishte hetuar rastin në fjalë. Mendoj se me të drejtë kam vendosur mosfillimin e procedimit penal dhe ky

vendim duhet t'i jetë njoftuar kallëzuesit si detyrim ligjor, por dhe në respektim të shkresës përcjellëse të Prokurorisë së Përgjithshme (Kabineti), ku kërkohej njoftimi mbi përfundimin e kallëzimit. Për rastin konkret dhe në raportin e hartuar nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, në lidhje me inspektimin e Ministrisë së Drejtësisë, nuk më është konstatuar vendimmarrje e kundraligjshme dhe nuk është shfuqizuar ky vendim.”

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nga ai nuk argumentohet fakti se cila ka qenë arsyeja që hetimet nuk kanë filluar, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim me veprime të kryera në vitin 2013. Gjithashtu, ai nuk jep asnjë sqarim në lidhje me moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore. Ai nuk provoi që vendimi i mosfillimit t'i jetë njoftuar kallëzuesit.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë shkeljet e shumta procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ato do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

❖ **Ankesa e shtetasit F.D.**

Shtetasi F.D., pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka marrë padrejtësisht të pandehur dhe e ka dërguar për gjykim për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal, si dhe ka pushuar padrejtësisht çështjen penale në ngarkim të shtetasit L.Q., për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, që kanë lidhje me të njëjtën ngjarje. Nga analizimi i dokumentacionit të gjendur në dosjen e ankimit rezultoi se:

1. Në lidhje me pretendimin e ankuesit se subjekti i rivlerësimit e ka pushuar padrejtësisht çështjen penale në ngarkim të shtetasit L.Q., për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme ka administruar fashikullin e procedimit penal nr. ***, viti 2008, prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë. Pas analizimit të çështjes janë evidentuar problematika lidhur me ndarjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit në një procedim të lidhur, administrimin e provave dhe pushimin e procedimit, si më poshtë:
 - Oficeri i policisë gjyqësore ka relatuar tek prokurori dërgimin e çështjes penale në gjyq, në ngarkim të shtetasve F.D., dhe L.Q.
 - Në datën 20.10.2008, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë ka marrë vendim për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës shtetasit F.D., për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, me pasojë vdekjen e shtetasit T.Q., parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal, dhe **vendim për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës shtetasit L.Q., për veprën penale “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i Kodit Penal. Vendimi për marrjen të pandehur të shtetasit L.Q., nuk i është komunikuar këtij shtetasi dhe mbrojtësit të tij.** Në po të njëjtën datë, 20.10.2008, prokurori ka vendosur ndarjen e çështjes penale nr. *** në dy çështje të tjera. Përkatësisht, çështjen penale nr. ***, në ngarkim të shtetasit F.D., dhe çështjen penale nr. ***, në ngarkim të shtetasit L.Q.
 - Në vendimin e ndarjes së procedimit dhe në as ndonjë akt tjetër të fashikullit të procedimit nr. *** nuk janë lënë detyra konkrete dhe, për më tepër, nuk është kryer asnjë veprim hetimor pas datës 20.10.2008 të ndarjes së procedimit, deri në pushimin e tij.

- Procesverbali me deklaratimet e dëshmitarëve në gjykim është administruar në fashikullin hetimor **jo në formën e kërkuar** nga ligji, neni 105-106, ose 193 i Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor është një kopje e pavërtetuar nga organi procedues.
- Shtetasi L.Q., në datën 17.6.2009 është pyetur në gjykim me cilësinë e dëshmitarit, sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale, në një kohë që ai ka qenë person ndaj të cilit zhvillohej hetimi për procedimin penal nr. ***, të lidhur, por edhe i pandehur (megjithëse akuza e ngritur nga prokurori nuk iu njoftua asnjëherë). Në mbështetje të nenit 156 të Kodit të Procedurës Penale ky shtetas **ka papajtueshmëri ligjore** për t'u pyetur si dëshmitar në atë procedim. Deklarimet e tij do të kishin vlerë në rast se do të ishin marrë në zbatim të nenit 167 të Kodit të Procedurës Penale.
- **Në deklaratimet e tij, shtetasi L.Q., në asnjë moment nuk ka pretenduar se ka qenë i detyruar të qëllorë mbi z. F.D., në kushtet e mbrojtjes së nevojshme.** Sulmi vërtet ka qenë i vërtetë, i padrejtë dhe i çastit, por nga koha kur prokurori në vendimin e njoftimit të akuzës ka arsyetuar se sulmi ka ndodhur në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë për të motivuar arsyetimin ndryshe. Edhe në rast se deklaratimet e shtetasit L.Q., në seancë gjyqësore do të quheshin rrethanë e re, ato janë marrë jo në përputhje me ligjin procedural.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit nuk duhet të kishte pushuar procedimin penal në ngarkim të z. L.Q.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti sqaroi: *“Në lidhje me ankesën e shtetasit F.D., ju informoj se çështjen penale në ngarkim të shtetasit F.D., e kam gjetur në fazën e hetimeve paraprake. ... Shumë dosje komplekse për vepra penale të rënda, që ishin deformuar provat gjatë hetimit, janë marrë prej meje në hetim, kjo gjë më është kërkuar nga Drejtoria e Hetimit në Prokurorin e Përgjithshme në atë kohë (qershor 2008). Në momentin që kam marrë dosjen në ngarkim të shtetasit F.D., (ka ndryshuar emrin disa herë) **gjëja e parë që kam konstatuar ka qenë fakti se provat ishin manipuluar dhe qëllimi ishte që ankuesi të dilte i pafajshëm, ky fakt vërtetohet dhe nga raporti inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme për këtë dosje... dhe sot që po jap shpjegime jam i bindur, në bazë të akteve, që shtetasi L.Q., ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme nuk ka konsumuar vepër tjetër penale, në rastin konkret. Dhe kartela klinike mbi të cilën ka dalë akti i ekspertimit mjeko-ligjor i ankuesit F.D., në atë kohë ka qenë e manipuluar, jo e saktë, por nuk mund të vërtetohet dot, pasi kishin kaluar shumë kohë. Në asnjë rrethanë shtetasi L.Q., nuk ushtronte dot dhunë ndaj ankuesit F.D. Ju lutem, merrni informacion për shtetasin F., (F.) D., kush është, dhe çfarë përfaqëson, të paktën në periudhën që unë kam qenë me punë në Sarandë.”***

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, për më tepër pretendimi i tij se provat ishin manipuluar cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi, nëse subjekti dyshonte se provat ishin manipuluar, ai duhet të fillonte menjëherë procedimin penal për të evidentuar fajtorët. Nga përgjigjet e subjektit, por dhe nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që të jetë bërë hetim në lidhje me manipulimin e provave duke i bërë shpjegimet e subjektit në nivel deklarativ.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se gabimet e kryera nga subjekti në këtë procedim do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

- ❖ **Në lidhje me denoncimet nga publiku për subjektin në Komision dhe hetimi i kryer i Komisionit në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit**

a. **Në lidhje me trajtimin e masës së sigurisë së shtetasit K.H.**

Në datën 6.8.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. *** ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit K.H., si i dyshuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, si dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”.

Ky vendim është ankimuar në datën 7.8.2018 nga shtetasi K.H., i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke ndryshuar masën e sigurimit personal nga “arrest në burg” në “garanci pasurore”.

Në datën 20.8.2018 subjekti i rivlerësimit ka përgatitur konkluzionet në lidhje me ankesën e shtetasit K.H., duke i kërkuar Gjykatës së Apelit Gjyrokastër ndryshimin e pjeshëm të vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke caktuar si masë sigurimi personal “arrest në burg 30 ditë”.

Subjekti i rivlerësimit e motivon kërkesën e tij duke u mbështetur në faktin që i dyshuari është në proces edukativ dhe sasia e lëndës narkotike është e vogël. Ai deklaroi se masa e sigurimit “arrest në burg” duhet të lihet me afat deri në administrimin e aktit të ekspertimit toksikologjik për të vërtetuar faktin nëse i dyshuari është përdorues i lëndëve narkotike.

Argumentimi i subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e masës së sigurimit është i paqartë pasi, pavarësisht faktit nëse i dyshuari është apo jo përdorues i lëndëve narkotikëve, ai nuk përjashtohet nga ndjekja penale. Pavarësisht kërkesës së subjektit të rivlerësimit Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, duke argumentuar se:

Nisur nga pretendimet e ngritura në lidhje me llojin e masës së sigurimit, Gjykata e Apelit çmon se masa e përshtatshme për t’u aplikuar në rastin konkret është ajo e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës penale, përhapjes së saj aktualisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe rrezikshmërisë së personit nën hetim. Shuma monetare e konsiderueshme gjetur të dyshuarit F.G., dhe fakti që të dyshuarit tjetër K.H., i janë gjetur dy lloje lëndësh të dyshuara si narkotike, konkretisht, kokainë dhe cannabis sativa, krijojnë dyshime në këtë fazë të hetimit se ata janë shpërndarës të lëndëve narkotike, për rrjedhojë, paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore. ... Për sa më sipër, nuk ka vend kufizimi i kohëzgjatjes së masës së sigurimit, sikurse kërkoi prokurori i apelit, sepse edhe nëse merren të mirëqena shpjegimet e të dyshuarit K.H., ai është përdorues i lëndës bimore narkotike cannabis dhe jo i kokainës. Porse, sikurse u arsyetua dhe më sipër, në analizë të rrethanave të faktit, sikurse paraqiten në këtë fazë të hetimit, krijohen dyshime se kemi të bëjmë me shpërndarje të lëndëve narkotike dhe kjo veprimtari kriminale paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Duke pasur për bazë këto dyshime, çmohet se masa e përshtatshme për t’u aplikuar është ajo e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nëse lihet i lirë, përpos që mund të largohet, personi nën hetim mund të vazhdojë aktivitetin kriminal me pasoja të rënda, veçanërisht në moshat e reja.

Në përfundim, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e masës së sigurisë nuk është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Ligji Procedural Penal dhe Praktika Gjyqësore.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi: “Nga sa parashitrova më sipër për rastin konkret ka qenë bindja ime e brendshme e mbështetur në ligjin procedural penal, kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, që ndaj të dyshuarit K.H., të kërkoja masën e sigurimit ‘arrest në burg’, me afat 30 ditë. Shtetasi K.H., sipas akteve në dosje (vendimi themelut), rezultoi përdorues i lëndës narkotike kokainë, dhe sasia prej 0.126 gram, sipas aktit të ekspertimit kimik, tregon praninë e kokainës. Me vendimin nr. ***, datë

14.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (që ndodhet në dosjen e hetimit administrativ), shtetasi K.H., është deklaruar fajtor për veprën penale 'prodhimi dhe shitje e narkotikëve', parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe ndaj dënimit me burgim është vendosur edhe mënyra e vuajtjes së dënimit, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim. Sipas informacionit verbal (me telefon, datë 26.6.2019) që mora nga Kancelaria e Gjykatës Sarandë, rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar në Gjykatën e Apelit. Në arsyetimin e vendimit që bën Gjykata Sarandë, konstatohet se shtetasi gjykuar K.H., është deklaruar fajtor për veprën penale "prodhim dhe shitje e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në formën e mbajtjes dhe jo të shpërndarjes apo mënyrë tjetër veprimi. Dhe njëherë, deklaroj se nuk jam dakord me konstatimet Tuaja për rastin konkret."

Pavarësisht shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, mbetet fakt se kërkesa e tij nuk është e mbështetur në ligjin procedural penal, për sa kohë ajo është rrëzuar nga gjykata e apelit, duke dhënë dhe argumentet përkatëse. Trupi gjykues vlerëson se mosargumentimi i kërkesës për masa sigurimi nga subjekti, nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e tij, por mbetet një element i cili, nga trupi gjykues, është konsideruar në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

2. Znj. Sh.H., dhe z. N.H., me denoncimin nr. *** prot., datë 24.5.2019, ankohen se kanë 18 vjet që sorollaten për të marrë drejtësi, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka luajtur rol negativ duke mbështetur z. K.Ç. Në ankimin e tyre ata pretendojnë se:

Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj tyre, si dhe i ka kërcënuar.

Subjekti i rivlerësimit ka pushuar disa herë kallëzimet e bërë nga znj. Sh.H., për shtetasin K.Ç.

- Në kallëzimin e vitit 2004 subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim mosfillimi për procedimin penal nr. ***, datë 6.12.2004, duke mbrojtur z. K.Ç.

Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se vendimi i mosfillimit të subjektit të rivlerësimit është prishur nga Gjykata e Apelit. Pas prishjes së vendimit të mosfillimit rezulton se çështja penale nr. *** është dërguar për gjykim, por gjykata ka vendosur deklarimin e pafajshëm të shtetasit K.Ç.

- Në kallëzimin e vitit 2006 e ka mbyllur pa asnjë veprim hetimor, duke vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga ankuesi rezulton subjekti i rivlerësimit ka firmosur në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë. Ky vendim pushimi është shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, në datë 8.4.2008. Pas kryerjeve të hetimeve nga i njëjti prokuror, në datën 13.6.2008 është vendosur sërish pushimi i procedimit penal me motivacion se nuk mund të bëhet ndjekja penale për shkak të parashkrimit.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti sqaroi se:

"Në lidhje me denoncimin e këtyre shtetasve (bashkëshortë), ju bëj me dije se gjatë gjithë punës time si prokuror apo si drejtues, në asnjë rast nuk kam ushtruar dhunë e çfarëdolloji qoftë ajo. Mendoj se kallëzimeve që ata kanë bërë u është dhënë zgjidhje e drejtë ligjore. Ju bëj me dije se në Gjykatën e Apelit Gjjirokastër, në bazë të ankimit të bërë nga Prokuroria e Shkallës së Parë Gjjirokastër është shqyrtuar vendimi nr. ***, datë 11.10.2017, me të pandehur shtetasin K.Ç., akuzuar për veprën penale 'Pengim për ekzekutimin e vendimit të gjykatës', të parashikuar nga neni 320 të Kodit Penal, ku kallëzues kanë qenë shtetasit Sh., dhe N.H. Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur deklarimin e pafajshëm të të pandehurit K.Ç. Gjatë

*Gjykimit në Apel është mbrojtur ankimi i prokurorisë së shkallës së parë. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.10.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Nga ana e prokurorit të Apelit Gj. F., kundër këtyre vendimeve është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, në datën 27.4.2018.”*

Komisioni nuk arriti të provojë se nga subjekti i rivlerësimit kishte shkelje ligjore në lidhje me rastet e pretenduara në ankim.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme. Në disa raste, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrit nr. 174, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “*Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore*” (dosjet 1, 2, 3, 4, 5 dhe dokumentet 1, 2, 3), me përjashtim të rastit të gjykimit me të dëmtuar akuzues, në të cilin prokurori ka qenë pjesëmarrës në gjykim, por jo si palë në debatin gjyqësor. Aktet e përpiluara prej tij janë administruar në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit.

Rezulton se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit janë mbështetur në përgjithësi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Në gjykimin e çështjes penale, titulluar në raport “dosja 4”, për të cilën Gjykata e Shkallës së Parë ka dhënë pafajësi për dy të pandehurit e gjykuar, nga Gjykata e Apelit është ndryshuar vendimi dhe një prej këtyre të pandehurve është deklaruar fajtor.

Bazuar në raportin e Ministrisë së Drejtësisë, trajtimin e masës së sigurisë të shtetasit K.H., por dhe në trajtimin e ankesës së z. F.D., rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me normat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Në rastin e evidentuar nga Ministria e Drejtësisë, subjekti nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të filluar procedimin penal, nuk ka kryer hetime paraprake, si dhe nuk ka ndër marrë veprime të mjaftueshme hetimore duke marrë në konsideratë faktin se në kallëzim paraqiteshin rrethana të ndodhura gjatë vitit 2013 pra, pas përfundimit të hetimeve për kallëzimin e vitit 2010. Subjekti i rivlerësimit nuk duhej të mbështeste mosfillimin e procedimit në pikën “dh” të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk rezulton që nga subjekti të jetë bërë njoftimi i vendimit të mosfillimit palëve, në kundërshtim me detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Në rastin e z. F.D., subjekti nuk ka ndër marrë të gjitha hapat hetimore, si dhe ka administruar prova jo në formën e kërkuar nga ligji.

Në rastin e z. K.H., subjekti nuk ka interpretuar si duhet ligjin procedural penal.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë arsyetimi dhe argumentimi logjik. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar përgjithësisht rregullat e drejtshkrimit dhe përdor përgjithësisht të

gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet kanë një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar dhe janë të konceptuara me tri pjesë. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruar për zgjidhje. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Bazuar në raportin e Ministrisë së Drejtësisë, në trajtimin e masës së sigurisë të shtetasit K.H., por edhe në trajtimin e ankesës së z. F.D., rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me normat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Në rastin e evidentuar nga Ministria e Drejtësisë ai nuk ka arsytuar vendimin e mosfillimit.

Në rastin e z. F.D., subjekti nuk ka argumentuar ndarjen e çështjes në dy çështje të tjera, si dhe nuk ka argumentuar vendimin e pushimit.

Në rastin e z. K.H., kërkesa e tij për caktimin e masës së sigurimit me afat nuk është e argumentuar, si dhe është e paqartë.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit dhe atë të drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Lidhur me efektivitetin e subjektit të rivlerësimit në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal. Referuar të dhënave statistikore për punën e kryer, rezulton se ai ka përballuar me efikasitet një ngarkesë të madhe pune.

Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve konstatohet se nga mënyra se si është organizuar dhe funksionon prokuroria, mbështetur në parashikimet ligjore procedurale penale, nuk ka ekzistuar ndonjë afat, brenda të cilit prokurori të detyrohej të arsyetonte aktet e saj. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale, ka paraqitur qëndrimin/vlerësimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe mban qëndrim për çështjet në gjykim. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura me short, qëndrimi i tij është sipas kërkesave të ligjit procedural penal, ndërsa bazuar në raportin e Ministrisë së Drejtësisë dhe analizën e ankesës së z. F.D., rezulton se ai nuk ka vepruar sipas kërkesave të ligjit procedural penal, duke mos kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik përgjithësisht, na njohin përgjithësisht me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, si dhe dispononim e gjykatave.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe nga dosjet e hedhura me short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Alfred Agolli të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndjekjen e studimeve pasuniversitare pranë Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë, në periudhën 2006 – 2009, duke u diplomuar me titullin “Master në Shkencat Penale”, mbrojtur me mikrotezën “Mjekim i pakujdesshëm”. Kjo konfirmohet me dokumentin Master, nr. regjistri ***, e fotokopjuar, lëshuar nga Universiteti i Tiranës.

Nga subjekti i rivlerësimit nuk është ndjekur formimi vazhdues, sipas parashikimeve të germës “a”, të nenit 5/2 dhe nenit 76/4-5 të ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Pasi i kaloi barra e provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime të cilat Komisioni vlerëson se nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar moskryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme të konstatuara në dosjet e mësipërme, mosnjohimin e vendimeve palëve të interesuara, mosargumentimin e vendimeve të pushimit apo mosfillimit.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve gjyqësore, të trajtuar më sipër, reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jo

korrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat bien ndesh me kriteret e parashikuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 73 dhe pikës 4, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, dhe, për pasojë, i vlerëson ato si cilësi të papranueshme në punë, një gjykim të dobët dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij. Në përfundim, në vlerësimin veç e veç, si dhe në tërësi të kriterit profesional, trupi gjykues konsideron se subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm në sistemin e drejtësisë, pasi është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollin të figurës, si dhe vlerësimin tërësor të procedurave konkludohet se:

A. Komisioni, për vlerësimin e pasurisë, arrin në konkluzionin se: për apartament banimi me sip. 68.5 m², ndodhur në lagjen “**”, ose lagjja “****”, Rr. “****”, Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit:**

- ka kryer deklarin të pamjaftueshëm dhe të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e apartamenti;
- ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. N.Dh., për dhënien e huas në shumën 3,000,000 lekë;
- i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me huan e marrë nga z. N.Dh.

B. Komisioni, për vlerësimin e aftësive profesionale, arrin në konkluzionin se: për të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve të trajtuar më sipër çmon se ato reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jo korrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat bien ndesh me kriteret e parashikuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 73 dhe pikës 4, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, dhe merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit rezulton se ai ka cenuar besimin e publikut.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në

bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të pikës 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Agolli, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 8.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
(Kryesues)

Olsi Komici
(Anëtar)

Roland Ilia
(Relator)

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore